



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 676 Akti

Nr. 747 Vendimi
Tiranë, më 21.3.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Etleda Çiftja	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 21.3.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim, mbi bazën e dokumenteve të administruara, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Olgert Rumnici**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, aktualisht i komanduar në pozicionin e këshilltarit ligjor pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, B, C, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të

provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Olgert Rumnici në seancë dëgjimore dhe, pasi shqyrtoi çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Olgert Rumnici, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, ka mbajtur funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat, për rrjedhojë, në zbatim të pikës 3 të kësaj dispozite dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, gëzon statusin e subjektit të rivlerësimit dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.

2. Z. Olgert Rumnici, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.12.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Brunilda Bektashi dhe Etleda Çiftja.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), sipas neneve 34-39 të ligjit nr. 84/2016; Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin datë 21.12.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Lulzim Hamitaj. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 13.1.2021, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe mbi përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni, gjithashtu, i kërkoi subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.

6. Trupi gjykues, me vendimin datë 12.3.2023, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Olgert Rumnici, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016, mbi të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin

¹ Email datë 13.1.2021, ora 12:19, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe, në datën 13.3.2023, përmes postës elektronike² i njoftoi subjektit të rivlerësimit vendimin mbi përfundimin e hetimit paraprak. Subjekti i rivlerësimit u ftua të paraqesë prova dhe shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit brenda datës 19.3.2024.

7. Në datën 19.3.2024, subjekti i rivlerësimit paraqiti me anë të postës elektronike³ shpjegime dhe prova në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht dhe, njëkohësisht, i paraqiti ato në zyrën e protokollit pranë Komisionit, administruar me shkresën nr. *** prot., datë 19.3.2024.

8. Subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike⁴ se trupi gjykues, me vendimin e datës 19.3.2024 vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 21.3.2024, ora 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

9. Bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Olgert Rumnici, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

10. Në datën 21.3.2024 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

11. Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e hetimit administrativ nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryera mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

12. Subjekti i rivlerësimit Olgert Rumnici, pasi dëgjoji relacionin, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

13. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Olgert Rumnici, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

14. Seanca dëgjimore e datës 21.3.2024 u ndërpre, për të rifilluar po në atë datë, 21.3.2024, ora 15:00, për shpalljen e vendimit.

15. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 21.3.2024, subjekti i rivlerësimit Olgert Rumnici kërkoi konfirmimin në detyrë.

² Email datë 13.3.2023, ora 11:01, "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit".

³ Email datë 19.3.2024, ora 11:59 dhe 12:31.

⁴ Email datë 19.3.2023, ora 13:53, "Ftesë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore për procesin tuaj të rivlerësimit".

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Subjekti i rivlerësimit Olgert Rumnici ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

18. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLP-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili, në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

19. Referuar vendimit nr. 2/20175 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

20. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Olgert Rumnici, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2013, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

⁵ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës ⁵ të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, ndërsa sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

21. Subjekti i rivlerësimit, në datën 25.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

22. Në kohën e plotësimit të deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka qenë në përbërje familjare vetëm, ndërsa në qershor të vitit 2020 ka lidhur martesë ligjore me znj. A. R. (B.).

23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI dhe në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2013 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit dhe, në vijim, gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

24. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konfliktit të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

❖ Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit

1. Depozitë në Intesa Sanpaolo Bank, në vlerën 800.000 lekë

1.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitë bankare në Intesa Sanpaolo Bank, në shumën 800.000 lekë, depozituar në datën 27.11.2015, me afat maturimi deri më 29.5.2017. Sipas kontratës, depozita maturohet në datën 29.5.2017 dhe shuma e interesit është 36.098,63 lekë. Burimi i krijimit: nga një pjesë e bursave nga Shkolla e Magjistraturës, të përfituara

në vitet 2011, 2012 e 2013. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues⁶.

1.2. *Nga hetimi i Komisionit konstatohet se* – Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2013, në rubrikën “Deklarimi i pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka deklaruar shumën 1.032.000 lekë, me përshkrimin “Bursat nga Shkolla e Magjistraturës, duke filluar nga nëntori 2011 deri në tetor 2013”. Më tej, në rubrikën e të ardhurave, ka deklaruar bursa nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën janar 2013 – tetor 2013, në shumën 387.000 lekë dhe ka shënuar që këto të ardhura janë pjesë e llogaritjes së shumës së paraqitur më lart. Në DIPP-në e vitit 2013, sërish në rubrikën “Deklarimi i pasurive dhe burimi i krijimit”, subjekti ka kryer të njëjtin deklaram si në DPF-në e vitit 2013. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar: *“Është hapur depozitë bankare në Intesa Sanpaolo Bank në datën 27.11.2015, me kursimet e krijuara nga bursat e Shkollës së Magjistraturës të deklaruara sipas deklaratës fillestare, shuma 800.000 lekë”*.

1.3. Intesa Sanpaolo Bank⁷ konfirmon depozitimin e kryer nga subjekti në datën 27.11.2015, në shumën 800.000 lekë, me përshkrimin “Cash deposit Olgert Rumnici, të ardhura nga bursa e Shkollës së Magjistraturës”. Referuar informacionit të përcjellë nga Raiffeisen Bank⁸ konstatohet se gjatë periudhës 2.11.2011 – 3.10.2013, subjekti ka kryer disa tërheqje, në shumën totale 1.030.140 lekë⁹, të cilat kanë si burim bursën nga Shkolla e Magjistraturës.

1.4. Sa më lart, Komisioni vëren, se edhe pse në DPF-në e vitit 2013 subjekti nuk ka deklaruar qartësisht që shuma 1.032.000 lekë ka qenë pasuri e luajtshme/likuiditet në gjendje *cash* – duket se kjo shumë i referohet pikërisht likuiditeteve që subjekti ka pasur jashtë sistemit bankar përpara fillimit të detyrës, pasi: (i) në DPF-në e vitit 2013 e ka deklaruar këtë shumë në seksionin e pasurive; (ii) në DIPP-në e vitit 2015 ka deklaruar se si burim për krijimin e depozitës kanë shërbyer kursimet e deklaruara në deklaratën fillestare; (iii) totali i shumave të tërhequra nga llogaria bankare pranë Raiffeisen Bank (1.030.140 lekë) është pothuajse e barabartë me shumën e deklaruar (1.032.000 lekë); (iv) në momentin e depozitimit të shumës 800.000 lekë në vitin 2015, është shënuar në përshkrim se bëhet fjalë për të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës.

1.5. Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 19.11.2015¹⁰, subjekti ka deklaruar se gjatë studimeve në Shkollën e Magjistraturës ka banuar në shtëpinë e prindërve dhe të gjithë bursën e përfituar e ka kursyer duke e lënë në familje.

1.6. I pyetur nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit nr. 1¹¹, subjekti shpjegoi se gjatë studimeve në Shkollën e Magjistraturës, përgjatë periudhës tetor 2011 – tetor 2013, shpenzimet e tij të jetesës janë mbuluar nga të ardhurat nga pagat e babait, pensioneve (për shkak të statusit të ushtarakut), kompensim me vendime gjyqësore të marra prej tij dhe kursimeve familjare të krijuara edhe këto

⁶ Kontrata e depozitës në Intesa Sanpaolo Bank, datë 27.11.2015, sipas së cilës rezulton depozitimi i shumës 800.000 lekë, në datën 27.11.2015, me afat maturimi deri më 29.5.2017. Norma e interesit 3, shuma e interesit është 36.098,63 lekë. Sipas vërtetimit të lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank në datën 9.1.2017, kreditimi i interesave të depozitës është në datën 29.5.2017.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 8.2.2021.

⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2021.

⁹ Në total janë kryer 24 veprime tërheqjeje *cash* nga llogaria bankare.

¹⁰ Përcjellë nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. *** prot., datë 28.9.2023.

¹¹ Përgjigje datë 23.2.2024, protokolluar në Komision me nr. ***.

kryesisht nga pagat e babait ndër vite. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues¹².

1.7. Në vijim të këtij deklarami, me qëllim verifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e likuiditeteve *cash* në shumën 1.032.000 lekë, të deklaruara përpara fillimit të detyrës, Komisioni kreu analizën financiare të familjes së subjektit për periudhën 1.11.2011 – 12.11.2013¹³, duke konsideruar: (i) të ardhurat e subjektit nga bursa e Shkollës së Magjistraturës¹⁴; (ii) të ardhurat e babait të subjektit nga pagat dhe pensioni¹⁵; (iii) të ardhurat e babait të subjektit nga dëmshpërblimi sipas vendimit të gjykatës¹⁶; (iv) shpenzimet e jetesës së subjektit, prindërve dhe vëllait të tij¹⁷; (v) shtesën e kursimeve në *cash* të deklaruara nga subjekti; (vi) shtesën e likuiditeteve në bankë gjatë periudhës 1.11.2011 – 12.11.2013¹⁸.

1.8. Nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kursimeve *cash* përpara fillimit të detyrës, në shumën 1.032.000 lekë, të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitës pranë Intesa Sanpaolo Bank në vitin 2015.

1.9. Në konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë pasuri, si dhe ka burime të ligjshme për çeljen e kësaj depozite.

2. Gjendje *cash*, në shumën 1.400.000 lekë

2.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 1.400.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga dhe shpërblime si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Berat (vitet 2013, 2014, 2015 e 2016). Për vërtetimin e deklaratimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues¹⁹.

¹² (i) Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2023, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve mbi të ardhurat bruto, neto, transfertat, dieta, shpërblime, të realizuara nga shtetasi Th. R. përgjatë periudhës dhjetor 1999 – prill 2008; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 14.11.2023, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve mbi pagat neto dhe pagesa të tjera të shtetasit Th. R. gjatë periudhës mars 1997 – maj 1999; (iii) vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, i kompanisë “****” sh.p.k., mbi pagat bruto gjatë periudhës dhjetor 2009 – dhjetor 2011; (iv) vërtetim nr. *** prot., datë 27.9.2016, i kompanisë “****.” mbi pagat e përfituara si i punësuar në periudhën 25.8.2011 – 11.1.2016; (v) shkresë nr. *** prot., datë 21.11.2023, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, ndër të tjera, edhe të dhënat për shtetasin Th. R. mbi masat e pensioneve të përfituara në periudhën 2010 – 2017; (vi) mandat tërheqje nga Raiffeisen Bank, datë 6.3.2013, së bashku me vendimet gjyqësore për kompensimin e burgimit të padrejtë.

¹³ Duke filluar nga data 1.11.2011 (data e kreditimit të parë i të ardhurave nga Shkolla e Magjistraturës) deri në datën 12.11.2013 (data e fundit përpara fillimit të detyrës).

¹⁴ Vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës.

¹⁵ (i) Vërtetim nr. *** prot., datë 27.9.2016, i kompanisë “****”, konfirmuar edhe në lëvizjet e llogarive bankare të babait të subjektit, konkretisht shuma 123.200 lekë, kredituar gjatë periudhës 1.11.2011 – 31.12.2011 (Intesa Sanpaolo Bank dhe BKT), shuma 320.320 lekë në vitin 2012 (Intesa Sanpaolo Bank dhe BKT), shuma 256.400 lekë, në harkun kohor 1.1.2013 – 12.11.2013; (ii) shkresë nr. *** prot., datë 21.11.2023, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, përlogaritur për periudhën 1.11.2011 – 12.11.2013.

¹⁶ (i) Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat nr. *** prot., datë 26.4.2012, konfirmuar në lëvizjet e llogarive bankare pranë Raiffeisen Bank të babait të subjektit të rivlerësimit, konkretisht në datën 5.3.2013 janë kredituar 495.900 lekë, me përshkrimin “V. GJYQI Th. R.” dhe në datën 6.3.2013 babai i subjektit ka tërhequr shumën 495.000 lekë.

¹⁷ Përlogaritur bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së, për periudhën 1.11.2011 – 12.11.2013 (2 muaj për vitin 2011, viti 2012 dhe 10.5 muaj për vitin 2013), konkretisht për 4 persona (subjekti, prindërit, vëllai).

¹⁸ Diferenca e gjendjes së llogarive bankare në datën 12.11.2013, me gjendjen e llogarive bankare të datës 1.11.2011.

¹⁹ Vërtetim nr. *** prot., datë 5.1.2017, lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat.

2.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se – Në deklaratën përpara fillimit të detyrës dhe në deklaratat periodike vjetore, subjekti ka deklaruar analizën e ecurisë së gjendjes së kursimeve *cash*, sa vijon:

Viti	Deklaruar në deklaratat e pasurisë	Shtesë	Pakësim	Gjendje progresive
Para fillimit të detyrës, datë 13.11.2013	Bursat nga Shkolla e Magjistraturës duke filluar nga nëntor 2011 deri tetor 2013 (<i>deklaruar në seksionin "Deklarimi i pasurive dhe burimi i krijimit"</i>)	1,032,000		1,032,000
Vjetore 2013	Deklarimi sipas deklaratës përpara fillimit të detyrës - Bursat nga Shkolla e Magjistraturës duke filluar nga nëntor 2011 deri tetor 2013	-	-	1,032,000
Vjetore 2014	Shtuar - kursime nga paga për periudhën 1.1.2014-31.12.2014, shuma 460.000 lekë	460,000		1,492,000
Vjetore 2015	Shtuar - kursime nga paga për periudhën 1.1.2015-31.12.2015, shuma 410.000 lekë	410,000		1,902,000
	Është hapur depozitë bankare në Bankën Intesa San Paolo, në datë 27.11.2015 me kursimet e krijuara nga bursat e Shkollës së Magjistraturës të deklaruara sipas deklaratës fillestare, shuma 800.000 lekë		800,000	1,102,000
Vjetore 2016	Shtuar - kursime nga paga për periudhën 1.1.2016-31.12.2016, shuma 430.000 lekë	430,000		1,532,000

Vetting	1,400,000
Diferenca	132,000

2.3. Komisioni vëren se referuar deklarimeve të subjektit ndër vite – gjendja në fund të vitit 2016, datë 31.12.2016, përlllogaritet 1.532.000 lekë, pra 132.000 lekë më pak se gjendja e deklaruar në deklaratën *Vetting*, në datën 27.1.2017.

2.4. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë arsyen e diferencës së mësipërme.

2.5. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi se shuma e deklaruar prej 1.400.000 lekësh përfaqëson gjendjen reale të likuiditeteve *cash* që ka disponuar në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*. Lidhur me arsyen e diferencës prej 132.000 lekësh, subjekti deklaroi se pak ditë përpara plotësimit të deklaratës *Vetting*, babai i tij është ndarë nga jeta (datë 21.1.2017) dhe ka kontribuar në mbulimin e një pjese të shpenzimeve të ceremonisë mortore, çka ka sjellë uljen e masës së likuiditeteve *cash* nga vlera 1.532.000 lekë në vlerën e deklaruar prej 1.400.000 lekësh. Në cilësinë e provës, subjekti ka paraqitur certifikatën e vdekjes së babait.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

2.6. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishtë të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe

provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

2.7. Subjekti i rivlerësimit justifikon krijimin e likuiditeteve *cash* me të ardhura të ligjshme, sipas përcaktimit të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, për pasojë burimi i krijimit është i justifikueshëm ligjërisht.

2.8. Sa rezulton, diferenca/pasaktësia e konstatuar lidhur me deklarimin e shumës totale të gjendjes *cash* në deklaratën *Vetting*, ndonëse konfirmohet si e tillë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, nuk cenon ligjshmërinë e të ardhurave të krijuara, për sa kohë subjekti shpjegoi se kjo shumë ishte shpenzuar për nevoja familjare dhe për sa kohë nuk afekton vlerësimin për burimin e krijimit të kësaj shume.

2.9. Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare të familjes së subjektit për periudhën 2014 – 2016²⁰, për të ardhurat, pasuritë, detyrimet dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit, prindërve dhe vëllait, me qëllim verifikimin e burimeve të ligjshme për shtesat e likuiditeteve *cash*, të krijuara gjatë këtyre viteve, të pasqyruara në tabelën më poshtë:

Përshkrimi	2014	2015	2016
Shtesë likuiditete <i>cash</i> (subjekti)	460,000	410,000	430,000
Pakësim likuiditete <i>cash</i> (subjekti)		-800,000	
Shtesë/pakësim likuiditete në bankë ²¹	-334	821,193	79,969
Total ndryshim likuiditete	459,666	431,193	509,969
Të ardhura subjekti nga pagat ²²	1,060,744	1,016,868	1,005,967
Të ardhura babai nga pagat ²³	345,847	539,882	842,112
Të ardhura babai nga pensioni ²⁴	178,141	149,048	154,734
Total të ardhura	1,584,732	1,705,798	2,002,813
Shpenzime jetese ILDKPKI - INSTAT (subjekti) ²⁵	219,998	224,276	235,092
Shpenzime jetese ILDKPKI - INSTAT (prindërit, vëllai)	659,994	672,828	705,276
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS ²⁶	21,017	17,895	17,585
Shpenzime për doktoraturën ²⁷	72,000	0	0
Total shpenzime	973,009	914,999	957,953
Balanca e fondeve²⁸	152,058	359,606	534,891

²⁰ Duke filluar nga data 1.11.2011 (data e kreditimit të parë i të ardhurave nga Shkolla e Magjistraturës) deri në datën 12.11.2013 (data e fundit përpara fillimit të detyrës).

²¹ Përlllogaritur si diferencë midis gjendjes së llogarive bankare në fund të vitit me atë në fillim të vitit.

²² Bazuar në kreditimet e evidentuara në llogarinë bankare të subjektit pranë Raiffeisen Bank dhe Intesa Sanpaolo Bank, konfirmuar edhe me shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2021.

²³ Bazuar në kreditimet e evidentuara në llogarinë bankare të babait të subjektit pranë BKT-së, Intesa Sanpaolo Bank dhe Credins Bank.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 21.11.2023, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë (paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1), përlllogaritur për periudhën 13.11.2013 – 31.12.2016.

²⁵ Shpenzime e jetesës u përlllogaritën për 1 person, bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së.

²⁶ Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në lëvizjet hyrje-dalje nëpërmjet sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit dhe u krahasuan/plotësuan me deklarimet e subjektit. Kostot u përcaktuan referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, vendim nr. 11-2019 (JR), datë 22.5.2019.

²⁷ Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar: “Në muajin prill 2014 kam depozituar në numrin e llogarisë bankare të Fakultetit të Drejtësisë UT pagesën për doktoraturën, në shumën prej 72.000 lekësh të reja. Burimi janë kursimet nga paga e punës”.

²⁸ Përlllogaritur: të ardhura minus ndryshim likuiditete minus shpenzime.

2.10. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezultoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme për krijimin e kursimeve/likuiditeteve *cash* gjatë periudhës 2014 – 2016 dhe nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit.

3. Llogari bankare në Intesa Sanpaolo Bank, në vlerën 3.759,79 lekë

3.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar llogari page në Intesa Sanpaolo Bank, nr. ***. Vlera: 3.759,79 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues²⁹.

3.2. Nga hetimi i Komisionit konstatohet se – Referuar informacionit të përcjellë nga Intesa Sanpaolo Bank³⁰, kjo llogari është hapur në datën 30.4.2014, në të cilën kreditohen pagat e subjektit.

3.3. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit dhe nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit për sa i përket kësaj llogarie bankare.

4. Llogari bankare në Intesa Sanpaolo Bank, në vlerën 0,78 lekë

4.1. Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar llogari bankare në Intesa Sanpaolo Bank, nr. *** (e gjeneruar nga vetë banka), në vlerën 0,78 lekë. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti paraqiti dokumentacion ligjor provues³¹.

4.2. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se – Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar llogari bankare në Intesa Sanpaolo Bank, nr. *** (kjo llogari është gjeneruar nga vetë banka). Referuar informacionit të përcjellë nga Intesa Sanpaolo Bank³², konstatohet se në këtë llogari është kryer depozitimi i shumës 800.000 lekë në datën 27.11.2015 dhe kalimi i saj në depozitë (trajtuar në pikën 1 të këtij vendimi). Më tej, deri në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, në këtë llogari nuk janë kryer veprime të tjera, përveç debitimit të komisioneve dhe interesave të *overdraft*-it.

4.3. Në konkluzion, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit dhe nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit për sa i përket kësaj llogarie bankare.

5. Lidhur me adresat e banimit

5.1. Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2013 dhe në DIPP-të e viteve 2013 – 2018, subjekti ka deklaruar si adresë banimi: rruga “****”, pallati “****”, apartamenti nr. **, shkalla nr. **, Njësia Bashkiake Nr. **, Tiranë.

²⁹ Vërtetim datë 9.1.2017 nga Intesa Sanpaolo Bank, ku rezultoi se z. Olgert Rumnici përveç depozitës në vlerën 800.000 lekë ka edhe dy llogari me balancë 3.759 lekë dhe 0,78 lekë.

³⁰ (i) Shkresë nr. *** prot., datë 8.2.2021; (ii) vërtetim i lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank në datën 9.1.2017, paraqitur në deklaratën *Vetting*.

³¹ Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Intesa Sanpaolo Bank në datën 9.1.2017, nga ku rezultoi se kjo llogari është hapur në datën 27.11.2015.

³² Shkresë nr. *** prot., datë 8.2.2021.

5.2. Në përgjigje të pyetësorit standard³³, subjekti ka deklaruar se nga momenti që ka marrë detyrën deri në tetor të vitit 2019, ka jetuar në banesën në pronësi të prindërve Th. e A. R., me nr. pasurie ***, z. k. ***, rruga “****”, pallati “****”, apartamenti nr. **, shkalla nr. ***, Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë. Pas ndarjes nga jeta të babait në vitin 2017 dhe pas lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë, kjo banesë është në pronësi të nënës së subjektit me 4/6 pjesë dhe subjektit e vëllait të tij me 1/6 pjesë secili. Rreth muajit tetor 2019 e në vijim, subjekti deklaroi se ka jetuar me bashkëshorten në apartamentin e blerë me kontratë sipërmarrjeje në rrugën “****”, nd. ***, h. ***, Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë.

5.3. Në DIPP-në e vitit 2017, subjekti ka deklaruar trashëgimi nga babai të pjesës prej 1/6 të apartamentit që ndodhet në rrugën “****”. Në pyetësorin standard, subjekti ka paraqitur dëshminë e trashëgimisë nr. ***, datë 10.3.2017, ku rezulton se ka trashëguar nga i ndjeri, babai i tij Th. R., 1/3 e pasurisë në pjesë të barabarta me nënën A. R. dhe vëllain M. R.. Sipas certifikatës së pronësisë nr. ***, datë 12.4.2017, ky apartament me sip. 120.48 m², ndodhur në rrugën “****”, godina ***, hyrja ***, Tiranë është në pronësi të shtetasës A. R. në pjesë 4/6 dhe shtetasve Olgert e M. Rumnici me nga 1/6 pjesë secili³⁴.

5.4. *Komisioni hetoi lidhur me origjinën e kësaj pasurie*, nga ku rezultoi se apartamenti me sip. 128 m², me adresë rruga “****”, është blerë nga prindërit e subjektit Th. dhe A. R. me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 25.12.2001, nga pala shitëse, shoqëria “****” sh.p.k., me çmim 2.800.000 lekë.

5.5. Pas administrimit të dokumentacionit të lëshuar nga FSHU-ja³⁵, konfirmohet se në emër të babait të subjektit, z. Th. R., është e regjistruar kontrata e furnizimi me energji elektrike nr. *** në instancën Tiranë, kategoria familjare, me adresë rruga “****”, godina ***, hyrja ***, kabina “****”, regjistruar më 20.1.2001.

5.6. Në përfundim, nuk u konstatuan problematika që kanë të bëjnë me procesin e rivlerësimit lidhur me këtë pasuri.

5.7. Më tej, nga hetimi i Komisionit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile³⁶, rezultoi se subjekti i rivlerësimit së bashku me prindërit dhe vëllain, në vitin 1997 janë transferuar nga qyteti i Beratit në qytetin e Tiranës në Njësinë Administrative Nr. ***. Në datën 14.10.2003, familja Rumnici ka ndryshuar vendbanim duke u vendosur në Njësinë Administrative Nr. ***, rruga “****”. Nëna e subjektit A. R. rezulton e regjistruar me adresë banimi në Njësinë Administrative Nr. ***, rruga “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***, Tiranë. Subjektit i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij rezultojnë të regjistruar në Njësinë Administrative Nr. ***, rruga “****”, nd. ***, h. ***, Tiranë.

5.8. Sikundër u përmend më sipër, në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se nga momenti që ka marrë detyrën deri në tetor 2019 ka jetuar në banesën në pronësi të prindërve. Por, nga hetimi vërehet se Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka përcjellë pranë Komisionit një

³³ Email datë 2.2.2021, ora 10:56.

³⁴ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 25.10.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit, i ndjeri Th. R., ka ndërruar jetë në datën 23.1.2017.

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 2.2.2021.

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 25.10.2023.

kërkesë të nënshkruar nga subjekti, në datën 30.9.2016, me anë të së cilës ka kërkuar të veçohet nga trangu familjar, për arsye se: “Kërkoj të ndahem nga familja e prindërve për të krijuar një familje timen, meqenëse jetoj më vete”.

5.9. Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti me anë të pyetësorit nr. 1³⁷, lidhur me mospërputhjen e konstatuara. Në përgjigje³⁸, subjekti deklaroi se në kërkesë-formularin që ka plotësuar në gjendjen civile është shprehur në mënyrë të pasaktë, pasi e ka formuluar në formë jo të duhur vullnetin dhe dëshirën për të jetuar më vete. Në përfundim deklaroi se i vetmi vendbanim nga momenti i fillimit të detyrës dhe deri në muajin tetor 2019 ka qenë banesa e prindërve në rrugën “***”, pallati “***”, apartamenti ***, shkalla ***, Tiranë, dhe se nuk ka pasur asnjë vendbanim tjetër as në Tiranë dhe as në ndonjë qytet tjetër.

5.10. Sa më sipër rezulton, nuk konstatohen problematika apo mospërputhje në deklaratimet e subjektit lidhur me adresat e banimit ndër vite.

6. Hetime të tjera

6.1. Lidhur me përfshirjen e personave të lidhur në deklaratën Vetting – Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se deri në muajin shtator të vitit 2016 ka qenë në përbërje familjare me prindërit dhe vëllain. Prej shtatorit 2016 e deri në qershor 2020 ka qenë në përbërje familjare vetëm dhe në qershor të vitit 2020 ka qenë në përbërje familjare me bashkëshorten A. R. (B.).

6.2. Komisioni vëren se ligji nr. 84/2016, datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hyrë në fuqi në datën 8.10.2016 (Fletorja Zyrtare nr. ***, datë 30.9.2016)³⁹. Bazuar në nenin 4/3 të ligjit, procesi i rivlerësimit fillon menjëherë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Sipas nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së.

6.3. Referuar deklaratimeve të subjektit në pyetësorin standard, ka bërë shpërndarje nga trangu familjar në periudhën shtator 2016 dhe në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë Vetting nuk ka depozituar deklarime veçmas mbi pasuritë, të ardhurat, detyrimet etj., për nënën dhe vëllain. Nga hetimi i Komisionit referuar informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile⁴⁰ rezultoi se subjekti është shpërndarur nga trangu familjar në datën 30.9.2016. Bazuar në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjendja faktike në certifikatën familjare për të gjithë periudhën e rivlerësimit është ajo çka përcakton rrethin e personave të lidhur që duhet të deklarohen, në kuptim të nenit 3, pika 13 dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016⁴¹.

³⁷ Email datë 19.2.2024, ora 15:21.

³⁸ Dokumentacioni i dorëzuar në Komision, protokolluar me nr. ***, datë 23.2.2024, gjithashtu dërguar në rrugë elektronike me emal-in e datës 23.2.2024, ora 10:10.

³⁹ Me vendimin e datës 25.10.2016, Gjykata Kushtetuese vendosi pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 84/2016, si dhe kërkimin e *amicus curia* nga Komisioni i Venecias në lidhje me pajtueshmërinë e këtij ligji me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Më tej, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, vendosi rrëzimin e kërkesës, me objekt: Shfuqizimi si i pajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

⁴⁰ Shkresë nr.*** prot., datë 12.2.2024.

⁴¹ Vendim nr. 11-2023 (JR), datë 28.3.2023.

6.4. Sa rezulton, Komisioni konstatoi se nëna dhe vëllai i subjektit të rivlerësimit nuk bëjnë pjesë në rrethin e personave të lidhur, të cilët në kuptim të ligjit nr. 84/2016 kanë pasur detyrimin që të deklaronin pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre, të ardhurat, detyrimet financiare dhe/apo interesa të tjera private, pasi nuk kanë qenë në të njëjtën certifikatë familjare në momentin që ligji ka hyrë në fuqi në datën 8.10.2016.

6.5. Në përfundim, nuk u konstatuan problematika lidhur me procesin e rivlerësimit.

6.6. Lidhur me kontratën e furnizimi me energji elektrike nr. *** – Nga hetimi i Komisionit, referuar dokumentacionit të administruar nga FSHU-ja⁴², rezultoi se në emër të babait të ndjerë të subjektit, shtetasit Th. M. R., identifikohet një kontratë furnizimi me energji elektrike nr. *** në instancën Tiranë, kategoria familjare, me adresë ***, kabina “****”. Komisioni iu drejtua përsëri FSHU-së⁴³, duke kërkuar të bëhen verifikimet përkatëse në terren, duke vënë në dispozicion gjeneralitet e sakta, adresën si dhe kopje të dokumentit të identifikimit të personit që ka lidhur kontratën me FSHU-në. Në përgjigje⁴⁴, u bë me dije se nuk disponohen kopje të kontratave para vitit 2007.

6.7. Në kushtet kur në regjistrin e të dhënave të Gjendjes Civile në Republikën e Shqipërisë identifikohet/rezulton vetëm një shtetas me emrin Th. M. R.⁴⁵, Komisioni me anë të pyetësorit nr. 1⁴⁶ i kërkoj shpjegime subjektit, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues lidhur me këtë pronë të regjistruar në emër të babit të tij, për mënyrën, kohën e përfitimit dhe statusin aktual të kësaj pasurie. Gjithashtu i kërkoj të japë shpjegime përse nuk është deklaruar pjesa takuese e kësaj pasurie pas lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë së babait.

6.8. Në përgjigje⁴⁷, subjekti deklaroi sa vijon: *“Lidhur me ekzistencën e kësaj kontrate furnizimi energjie elektrike, unë jam vënë në dijeni pikërisht nga pyetja që ka formuluar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Nga të dhënat e kontratës që janë cituar kam arritur të identifikojë, përmes adresës së dhënë (***), se bëhet fjalë për një objekt, i tipit garsionere me sipërfaqe rreth 25-30 m², ku përgjatë viteve qershor 1997 – nëntor 2000 familja ime e përbërë nga prindërit, unë dhe vëllai kemi banuar në këtë garsionere, kati përdhes i një pallati 5 apo 6-katësh, që është pranë ish-hotel “****” në Rrugën e ****” (***). Kjo garsionere në pjesën veriore kufizohet me një familje me mbiemër P., në pjesën jugore ka qenë vazhdimi i pallatit, në pjesën perëndimore ka qenë hotel “****” dhe në pjesën lindore që ka qenë edhe hyrja e garsioneres përkonte me sheshpushimin e pallatit. Lidhur me këtë garsionere, babai është vënë në posedim faktik të saj rreth qershorit 1997, por për shkak të moshës së vogël atëherë (afro 9 vjeç), nuk kam dijeni për llojin e marrëdhënies juridike që mund të jetë përdorur në atë periudhë. Në dijeninë time, pas periudhës tetor – nëntor 2000 babai nuk ka pasur ndonjë marrëdhënie tjetër juridike, pronësie apo posedimi me këtë garsionere”.*

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 2.2.2021.

⁴³ Shkresë nr. *** prot., datë 24.1.2024.

⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 14.2.2024.

⁴⁵ I datëlindjes 23.8.1959, me nr. personal ***.

⁴⁶ Email datë 19.2.2024, ora 15:21.

⁴⁷ Dokumentacioni i dorëzuar në Komision protokolluar me nr. ***, datë 23.2.2024, gjithashtu dërguar në rrugë elektronike me emal-in e datës 23.2.2024, ora 10:10.

6.9. Më tej, subjekti shpjegoi se prindërit e tij nuk kanë pasur të drejta pronësie mbi këtë objekt dhe nuk disponojnë asnjë lloj titulli për të. Objekti ka qenë në administrim të Bashkisë Tiranë, por për shkak të kohës së gjatë dhe moshës së tij të vogël në atë periudhë nuk disponon ndonjë të dhënë apo dokumentacion për mënyrën e vënies në posedim të këtij objekti, për shkak se me këtë gjë është marrë babai i tij. Posedimi i këtij objekti ka qenë i përkohshëm (deri në nëntor të vitit 2000), më pas nuk kanë pasur asnjë të drejtë pronësie mbi të, dhe se prindërit e tij nuk kanë kryer asnjë lloj transaksioni financiar apo juridik me ndonjë palë apo subjekt. Subjekti deklaroi se nuk ka asnjë pjesë takuese në këtë objekt, duke sqaruar se nuk do të kishte ndonjë arsye apo pengesë për të deklaruar një objekt të tillë, që për më tepër do të ishte në pronësinë e tij, përmes trashëgimisë. Për të mbështetur deklaratimet e tij, në cilësinë e provës paraqiti dokumentacionin vijues: (i) shkresa nr. *** prot., datë 22.2.2024, lëshuar nga ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri, e cila bën me dije se në emër të prindërve të subjektit ka figuruar vetëm pasuria e paluajtshme apartament, e regjistruar tashmë në emër të shtetasve Olgert, M. dhe A. Rumnici, me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, me sip. 120.48 m², për të cilën është regjistruar dëshmia e trashëgimisë nr. ***, datë 10.3.2017, bashkëlidhur kartela e pasurisë (*bëhet fjalë për apartamenti me adresë rruga “****”, pallati “****”, apartamenti ***, shkalla ***, Tiranë*); (ii) shkresa nr. *** prot., datë 22.2.2024, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, e cila bën me dije se pas verifikimeve të kryera, objekti në fjalë rezultoi me adresë: Rruga e ***, pallati nr. ***, shkalla ***, apartamenti ***, Tiranë, me nr. pasurie ***, z. k. ***, me sipërfaqe totale 108 m², në pronësi të shtetasve K. P. dhe A. P.; (iii) shkresa nr. *** prot., datë 22.2.2024, lëshuar nga FSHU-ja, e cila bën me dije se kontrata nr. ***, me kod klienti *** (kontratë provizore), i përket abonentit Th. R., e hapur në datën 8.12.1999, aktualisht rezultoi në sistem me statusin “mbyllur”. Nuk disponojnë kopje të kontratave para vitit 2007, pasi furnizimi me energji elektrike menaxhohej nga KESH.

6.10. Pas analizimit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni vëren se subjekti, me kërkesën e datës 20.2.2024, ka kërkuar informacion lidhur me këtë pronë nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, duke dhënë si referencë të dhënat që rezultojnë në kontratën e furnizimit me energji elektrike, duke përshkruar vendndodhjen dhe kufitarët e objektit, si dhe duke evidentuar pozicionimin e garsonieres me anë të ortofotove të nxjerra nga gjeoportali ASIG.

6.11. Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike në përgjigjen e dërguar ka konfirmuar se shtetasit K. dhe A. P. e kanë përfituar pronën apartament në vitin 1994 me anë të privatizimit. Apartamenti është i pozicionuar në shkallën 4 të pallatit nr. ***, me emërtimin e vjetër rruga “****”⁴⁸. Referuar materialit bashkëlidhur, rezultoi se ky apartament me sip. 108 m², me adresë Rruga e ***, pallati nr. ***, shkalla ***, apartamenti ***, Tiranë, me nr. pasurie ***, z. k. ***, është privatizuar nga bashkëpronarët P. me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 19.9.1994. Gjithashtu, referuar certifikatës së pronësisë të lëshuar në datën 14.5.2007, ky apartament figuroi i regjistruar në emër të shtetasve K. dhe A. P..

6.12. Komisioni konstatoi se: (i) të dhënat e evidentuara në kontratën e furnizimi me energji elektrike në instancën Tiranë, me adresë Rruga e ***, kabina “****”, përputhen me të dhënat e

⁴⁸ Sipas dokumentacionit që disponohet në arkivin e kësaj drejtorie, nuk janë regjistruar familjarët që kanë disponuar kontratë qiraje me ish-Ndërmarrjen Komunale të Banësive. Referuar vendimit nr. ***, datë 30.12.1993 “Për shpërndarjen e kontingjentit të strehimit” nga Bashkia Tiranë, nuk figuron emri i babait të subjektit Th. R..

administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike lidhur me apartamentin në pronësi të shtetasve K. dhe A. P., me adresë Rruga e ***, pallati nr. ***, shkalla ***, apartamenti ***, Tiranë; (ii) ky apartament është përfituar nga bashkëpronaret P. me anë të privatizimit në datën 19.9.1994; (iii) certifikata e pronësisë e lëshuar në datën 14.5.2007 vërteton se ky apartament është i regjistruar në emër të bashkëpronarëve ***; (iv) çdo veprim i kryer në vijimësi është realizuar nga bashkëpronarët ***⁴⁹; (v) veprimet për hapjen/regjistrimin e kontratës së energjisë elektrike janë kryer nga babai i subjektit në datën 8.12.1999, periudhë në të cilën subjekti ka qenë fëmijë; (vi) nga hetimi i Komisionit, ASHK-ja konfirmon vetëm apartamentin me adresë rruga “***”, pallati “***”, apartamenti ***, shkalla ***, Tiranë, në pronësi të prindërve të subjektit, i blerë në vitin 2001; (vii) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile konfirmon se në datën 14.10.2003 familja Rumnici është vendosur në Njësinë Administrative Nr. ***, rruga “***”.

6.13. Sa më sipër rezultoi, nuk gjendet/evidentohet asnjë lidhje e subjektit të rivlerësimit me këtë pronë, si dhe çdo veprim i kryer daton para se subjekti Olgert Rumnici të fillonte detyrën dhe të emërohej prokuror në vitin 2013.

6.14. Në përfundim, nuk u konstatuan problematika që kanë të bëjnë me procesin e rivlerësimit lidhur me këtë pasuri.

6.15. Më tej, Komisioni pas administrimit të DIPP-së së vitit 2018, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së për efekt të ligjit nr. 84/2016, konstatoi se subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar një kontratë sipërmarrjeje apartamenti nr. *, datë 28.3.2018.** Duke u njohur me këtë kontratë sipërmarrjeje të vitit 2018, kreu hetim lidhur me vërtetësinë e të dhënave të deklaruara dhe burimet e krijimit të këtij apartamenti në vitin 2018, për të verifikuar nëse një subjekt rivlerësimi do të justifikonte kryerjen e shpenzimeve pas vitit 2016 me të ardhura të padeklaruara apo të pretenduara të akumuluar deri në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* 2017. Sa rezulton, Komisioni pyeti subjektin dhe hetoi lidhur me apartamentin me sip. 116,5 m², në Tiranë, blerë në vitin 2018, deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2018 (pas deklaratës *Vetting* 2017).

6.16. Për sa më sipër, Komisioni hetoi vetëm lidhur me faktin nëse të ardhurat dhe burimet e përdorura mund të kishin lidhje me deklaratimet e subjektit në deklaratën *Vetting* 2017, nga ku u konstatua se në DIPP-në e vitit 2018, subjekti ka deklaruar kontratë sipërmarrjeje apartamenti nr. ***, datë 28.3.2018, me palë sipërmarrëse “***” dhe “***” sh.p.k. dhe palë porositëse A. B. dhe Olgert Rumnici, në vlerën totale 70.000 euro. Paguar gjysma e çmimit nga shtetasja A. B. dhe gjysma tjetër nga subjekti i rivlerësimit. Si burim krijimi për pagesën e bërë nga ana e tij në vlerën 35.000 euro janë kursimet *cash*, depozitat, kredia në Intesa Sanpaolo Bank dhe huaja nga shtetasi N. B.. Pjesa takuese: 50%.

6.17. Komisioni vëren se është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 28.3.2018, me palë sipërmarrëse “***” dhe “***” sh.p.k. dhe palë porositëse A. B. dhe Olgert Rumnici, për blerjen e një apartamenti me sip. 116,5 m², me çmim 70.000 euro, në fazë ndërtimi, me adresë Rruga e *** (zona e ***), z. k. ***. Në kontratë përcaktohet se pagesa e plotë do të realizohet në momentin e lidhjes së kontratës. I pyetur nga ILDKPKI-ja në procesverbalin e datës 16.6.2021, subjekti ka

⁴⁹ Siç është edhe aneks-kontrata e lidhur në datën 30.4.2022 ndërmjet shtetasve K. e A. P. dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike për saktësimin e sipërfaqes së apartamentit të mësipërm nga 82 m² në 108 m².

deklaruar se është në pritje të përfundimit të procedurave për kryerjen e kontratës përfundimtare të shitjes me firmën ndërtuese.

6.18. Komisioni verifikoi të dhënat lidhur me vlerën mesatare të shitblerjeve në tregun e lirë të apartamenteve për vitin 2018⁵⁰, në qytetin e Tiranës, nga ku rezultoi se çmimi ka qenë në shumën 65.000 lekë/m². Për pasojë, apartamenti i porositur sipas çmimeve të referencës llogaritet në shumën 7.572.500 lekë⁵¹, përkundrajt çmimit prej 9.203.600 lekësh⁵² të përcaktuar në kontratën e shitjes, pra 1.631.000 lekë më shtrenjtë se vlera mesatare e tregut.

6.19. Lidhur me momentin e fillimit të banimit në këtë apartament, konstatohet se në pyetësin standard subjekti ka deklaruar se rreth muajit tetor 2019 e në vijim ka jetuar me bashkëshorten në apartamentin e blerë me kontratë sipërmarrjeje në rrugën “****”; nd. ***, h. ***, Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë.

6.20. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 16.6.2021, subjekti ka paraqitur librezën e lëshuar nga UK Tiranë, ku rezulton se kontrata për këtë apartament me adresë Rruga e ***, pallati “****”, kati ***, apartamenti ***, është lidhur në emër të bashkëshortes së subjektit A. B. (faturimet fillojnë në janar 2019). Gjithashtu, kontrata e furnizimit me energji elektrike është e regjistruar në emër të shtetasës A. B. (faturimet kanë filluar në qershor 2019).

6.21. Nga hetimi i Komisionit⁵³ në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, Tiranë dhe Shkodër nuk u provua qenia e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit me ndërtuesit dhe shoqëritë “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k.⁵⁴.

6.22. Lidhur me shumën 35.000 euro të paguar nga subjekti i rivlerësimit – Sipas mandatit të paraqitur, në llogarinë bankare të shoqërisë “****” sh.p.k. pranë Credins Bank, në datën 28.3.2018, është depozituar shuma 35.000 euro, me përshkrimin “Likuidim ap. k/nr. *** rep., *** kol., Olgert Rumnici kursime + borxh + interesa”.

6.23. Në vijim të analizimit të deklarimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, konstatohet se për pagesën e shumës 35.000 euro janë përdorur burimet sa vijon, në total shuma 4.614.500 lekë: (1) kursimet *cash* të deklaruara në deklaratën *Vetting* në shumën 1.400.000 lekë; (2) kursimet *cash* gjatë vitit 2017 në shumën 80.000 lekë; (3) kursimet *cash* gjatë periudhës janar – mars 2018 në shumën 50.000 lekë; (4) huaja nga vjehri, datë 26.3.2018, në shumën 550.000 lekë; (5) tërheqje *cash* në datën 27.3.2018 nga Intesa Sanpaolo Bank, në total shuma 2.534.500 lekë, që ka si origjinë: (i) depozitën bankare të deklaruar në deklaratën *Vetting* (800.000 lekë); (ii) kredinë bankare datë 26.3.2018 (1.400.000 lekë); (iii) depozitën bankare datë 5.3.2018 (346.634 lekë).

6.24. Referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁵⁵, kontrolli i të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara në deklaratat e interesave privatë për vitet pas deklarimit *Vetting* kryhet

⁵⁰ VKM nr. 132, datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.

⁵¹ Sip. 116,5 m² * 65.000 lekë/m².

⁵² 70.000 euro * 131,48 lekë sipas kursit të Bankës së Shqipërisë.

⁵³ Përkatësisht shkresat nr. *** prot., datë 11.1.2024, nr. *** prot., datë 11.1.2024 dhe nr. *** prot., datë 11.1.2024.

⁵⁴ Përkatësisht shkresat nr. *** prot., datë 23.1.2024, nr. *** prot., datë 30.1.2023 dhe nr. *** prot., datë 24.1.2024.

⁵⁵ Vendimet nr. 08-2021 (JR), datë 9.3.2021 dhe nr. 22-2022 (JR), datë 22.6.2022.

nga ILDKPKI-ja, pasi duke qenë subjekt deklarimi i nënshtrohet kontrollit të vazhdueshëm për shkak të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Referuar praktikës së Kolegjit, më konkretisht në vendimin nr. 08-2021 (JR), datë 9.3.2021, është vlerësuar se: “*Analiza e shpenzimeve të kryera pas dorëzimit të deklaratës Vetting mund të kishte relevancë për procesin e rivlerësimit në rrethana specifike. Konkretisht, nëse një subjekt rivlerësimi do të justifikonte kryerjen e shpenzimeve pas vitit 2016 me të ardhura të padeklaruara apo të pretenduara të akumuluar deri në momentin e dorëzimit të deklaratës Vetting, do të ishte e arsyeshme analiza nga Komisioni [ose Kolegji] në kushtet kur krijohet dyshimi për deklarin të pasaktë dhe të pavërtetë në deklaratën Vetting*”.

6.25. Komisioni vëren se likuiditetet për të cilat është deklaruar se janë përdorur si burim për këtë apartament, të krijuara deri në momentin e deklarin në deklaratën *Vetting* – konkretisht kursimet *cash* në shumën 1.400.000 lekë dhe depozita prej 800.000 lekësh – janë trajtuar në pikat përkatëse të këtij vendimi. Gjithashtu, nga hetimi nuk rezultoi që ky apartament të jetë përdorur apo deklaruar si adresë nga ana e subjektit deri në momentin e deklarin në deklaratën *Vetting*, pasi – siç është parashikuar në kontratën e sipërmarrjes datë 28.3.2018 – ky apartament nuk ishte ndërtuar ende⁵⁶.

6.26. Sa rezultoi, Komisioni konfirmon vërtetësinë dhe saktësinë e deklaratës *Vetting* 2017 dhe nuk konstaton problematika të cilat kanë të bëjnë me procesin e rivlerësimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

7. Analiza financiare

7.1. Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.11.2011 – 31.12.2016, e cila paraqitet e përmbledhur në tabelën vijuese:

⁵⁶ Në nenin 1.1 të kontratës parashikohet se objekt i kësaj kontrate është shitja e apartamentit që do të ndërtohet nga ana e palës sipërmarrëse në Rrugën e *** (zona e ***), zona kadastrale 8210.

Nr	Pasuri	1.11.2011 - 12.11.2013	13.11.2013- 31.12.2013	2014	2015	2016	Total (nëntor 2011-2016)
1	Shtesë/pakësim likuiditete cash	1,032,000	0	460,000	-390,000	430,000	1,532,000
2	Shtesë/pakësim llogari bankare	2,261	14,439	-334	821,193	79,969	917,527
Total pasuri		1,034,261	14,439	459,666	431,193	509,969	2,449,527
	Te ardhura	1.11.2011 - 12.11.2013	13.11.2013- 31.12.2013	2014	2015	2016	Total (nëntor 2011-2016)
1	Të ardhura subjekti nga bursa nga Shkolla e Magjistraturës	1,045,330	-				1,045,330
2	Të ardhura subjekti nga pagat			1,060,744	1,016,868	1,005,967	3,083,579
3	Të ardhura babai nga pagat	699,920	53,280	345,847	539,882	842,112	2,481,041
4	Të ardhura babai nga pensioni	493,148	31,770	178,141	149,048	154,734	1,006,840
5	Të ardhura babai nga dëmtshpërblymi dt.5.3.2013	495,000					495,000
Totali i te ardhurave		2,733,398	85,050	1,584,732	1,705,798	2,002,813	8,111,790
	Shpenzime	1.11.2011 - 12.11.2013	13.11.2013- 31.12.2013	2014	2015	2016	Total (nëntor 2011-2016)
1	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT (subjekti)	287,190	17,628	219,998	224,276	235,092	984,184
2	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT (prindërit, vëllai)	861,570	52,884	659,994	672,828	705,276	2,952,552
3	Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	-	-	21,017	17,895	17,585	56,496
4	Shpenzime për doktoraturën			72,000			72,000
Totali i shpenzimeve		1,148,760	70,512	973,009	914,999	957,953	4,065,232
	ANALIZA FINANCIARE	1.11.2011 - 12.11.2013	13.11.2013- 31.12.2013	2014	2015	2016	Total (nëntor 2011-2016)
1	Të ardhurat	2,733,398	85,050	1,584,732	1,705,798	2,002,813	8,111,790
2	Pasuri	1,034,261	14,439	459,666	431,193	509,969	2,449,527
3	Shpenzime	1,148,760	70,512	973,009	914,999	957,953	4,065,232
4	Detyrimet	-	-	-	-	-	-
Diferenca per shpenzime / balanca e fondeve		550,377	99	152,058	359,606	534,891	1,597,031

7.2. Nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve.

7.3. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Olgert Rumnici ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK)⁵⁷ ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 12.12.2023, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit Olgert Rumnici: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Olgert Rumnici.

⁵⁷ AKSIK

3. Komisioni me anë të shkresës nr. *** prot., datë 3.10.2023, kërkoi përditësimin e raportit me materialet shtesë që mund të disponoheshin në vijim, nga ku rezultoi se organet verifikuese kanë administruar informacione shtesë referuar subjektit të rivlerësimit Olgert Rumnici. Referuar indicieve të marra, Komisioni hetoi dhe administroi të gjitha dosjet e procedimeve penale. Në përfundim të hetimeve, u konstatua se këto çështje nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit të figurës, por u trajtuan në lidhje me kriterin e rivlerësimit profesional të këtij subjekti.

4. **Në konkluzion**, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit Olgert Rumnici ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, **duke konkluduar se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.**

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Subjekti i rivlerësimit Olgert Rumnici, me dekretin e Presidentit të Republikës nr. ***, datë 8.11.2013, është emëruar prokuror në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Me dekretin nr. ***, datë 3.12.2014, emërohet prokuror në këtë prokurori. Me urdhrin nr. ***, datë 13.11.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm, komandohet prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Me urdhrin nr. ***, datë 25.1.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është ndërprerë komandimi dhe është vendosur rikthimi në pozicionin e tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Me vendimin nr. ***, datë 27.4.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë. Me vendimin nr. ***, datë 23.2.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është komanduar në pozicionin e këshilltarit ligjor pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Me vendimin nr. ***, datë 24.4.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është vendosur transferimi i përhershëm në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik e profesional të subjekteve në proces rivlerësimi” ka miratuar një raport të hollësishëm të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Këto kriterë janë bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Drejtorisë së Menaxhimit të Dokumentacionit, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

Aftësitë profesionale

3. *Njohuritë ligjore* – Në dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti i rivlerësimit identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj.

4. *Arsyetimi ligjor* – Subjekti i rivlerësimit, për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016 është vlerësuar në masën “shumë mirë”, dokumentuar me aktet e lëshuara nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet përkatëse. Konstatohet se subjekti bën një analizë të zgjeruar mbi rrethanat e faktit, provat e mbledhura, provat e paraqitura nga mbrojtja, si dhe kërkesat dhe pretendimet e palëve/mbrojtjes, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore të çështjeve në ndjekje.

Aftësitë organizative

5. *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë* – Duke pasur parasysh statistikën e ngarkesës së punës, si dhe natyrën e çështjeve, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Olgert Rumnici është përballur me një ngarkesë të lartë pune.

6. *Aftësia për të kryer procedurat hetimore* – Veprimet procedurale hetimore rezultojnë të jenë produktive, duke mbledhur provat e aktet e nevojshme, duke konkluduar në një vendimmarrje dhe duke respektuar detyrimin për njoftimet përkatëse palëve. Gjithashtu, vihet re se qëndrimi i prokurorit në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik.

7. *Aftësia për të administruar dosjet* – Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve dhe rregullsisë së akteve. Por, nga hetimi i Komisionit, në një prej dosjeve penale të shortuara “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, datë 28.2.2014”, akt i datës 15.12.2014, për veprën penale “Organizimi i lotarive të palejuara”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal, në ngarkim të personit nën hetim, shtetasit I. H., ka rezultuar sa vijon:

8. *Rrethanat e faktit* – Në datën 27.2.2014, rreth orës 13:30, në bazë të informacionit të siguruar nga Krimi Ekonomik, është ushtruar kontroll në lokalitë të shtetasit I. H., ndodhur në ***/Berat, ku gjatë kontrollit janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës pajisje elektronike për lotari sportive të kompanisë “****”, si dhe pajisje elektronike të destinuara për lojërë fati për gara me qen. Gjatë kontrollit dhe këqyrjes, këto pajisje janë fiksuar në gjendje të ndezur dhe pune. Nga ana e organit procedues është vendosur kryerja e ekspertimit kompjuterik dhe është administruar akti i ekspertimit.

9. Komisioni vëren se akti i ekspertimit teknik është realizuar që në datën 10.6.2014, ndërkohë që subjekti ka zgjatur afatet e hetimeve edhe dy herë për administrimin e tij. Gjithashtu, rezultoi se për administrimin e certifikatës personale, familjare dhe vërtetimin e gjendjes gjyqësore të personit nën hetim, është bërë kërkesë vetëm në datën 15.12.2014, ndërkohë që subjekti ka zgjatur afatet e hetimeve edhe tri herë të tjera për administrimin e këtyre akteve⁵⁸.

⁵⁸ Subjekti ka marrë vendim për zgjatjen e afateve të hetimit sa vijon: 1. Në datën 28.5.2014, për zgjatjen e afatit të hetimeve për 3 muaj, duke filluar nga data 28.5.2014 deri më 28.8.2015, pasi nga ana e organit të akuzës vlerësohet se është i nevojshëm administrimi i aktit të ekspertimit teknik-kompjuterik, administrimi i vërtetimit të gjendjes gjyqësore, njoftim akuze, njohje me aktet dhe pyetja në cilësinë e të pandehurit të shtetasit I. H. 2. Në datën 28.8.2014, zgjatjen e afatit të hetimeve për 3 muaj, duke filluar nga data 28.8.2014 deri më 27.11.2014, pasi vlerësohet se është e nevojshme kryerja e disa veprimeve të tjera hetimore, konkretisht administrimi i aktit të ekspertimit teknik-vlerësues. 3. Në datën 27.11.2014, zgjatjen e afatit të hetimeve për 3 muaj, duke filluar nga data 28.11.2014 deri më 28.2.2015, pasi vlerësohet se është e nevojshme të pyetet shtetasi I. H. në cilësinë e të pandehurit, si dhe të administrohen aktet certifikata personale e familjare për këtë shtetas, si dhe gjendja gjyqësore. Në datën

10. Sa rezulton, duket e panevojshme zgjatja e afateve të hetimit tri herë për kryerjen e veprimeve hetimore të njëjta, të cilat ishin caktuar të kryheshin që në fillim të këtij procedimi penal, si dhe janë urdhëruar të kryhen në zgjatjen e parë të afateve të hetimit në kuadër të këtij procedimi penal.

11. Për sa më sipër, subjekti paraqiti shpjegimet e tij në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se: Nuk ka qenë e mundur të realizohen brenda afatit kohor të caktuar veprimet hetimore të urdhëruara me urdhrin e datës 28.2.2014, veçanërisht kryerja e ekspertimit teknik-kompjuterik. Me vendimmarrjen përkatëse të datës 24.3.2014, oficeri i policisë gjyqësore ka disponuar për kryerjen e këtij ekspertimi drejtuar Drejtorisë së Policisë Shkencore. Gjithashtu, i është adresuar kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me nr. ***, datë 27.3.2014, për vënien në dispozicion të dëshmisë së penalitetit për shtetasin I. H., por nga ky institucion nuk është dërguar përgjigje. Për këtë arsye, vendimi i zgjatjes së afatit datë 28.5.2014 është ndërmarrë në përputhje me nevojat e hetimit dhe ligjin procedural penal.

Ekspertimi kompjuterik i kryer nga Drejtoria e Policisë Shkencore Tiranë nr. ***, datë 10.6.2014, nuk është administruar në fashikullin hetimor të kësaj çështjeje penale në këtë datë, për shkak se nuk është dërguar në Prokurorinë e Rrethit Berat, por në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat, fakt për të cilin subjekti deklaroi se nuk mund të kishte dijeni dhe se oficeri i ngarkuar me hetimin e çështjes ishte transferuar nga pozicioni i punës⁵⁹. Për rrjedhojë, vendimi i zgjatjes datë 28.8.2014 është ndërmarrë në përputhje me nevojat e hetimit, duke qenë se faktikisht akti i ekspertimit kompjuterik nuk ka qenë i administruar në dosje.

Më tej, rezulton se edhe oficeri i dytë i çështjes është zëvendësuar me vendimin e drejtuesit të Prokurorisë të datës 17.11.2014, duke u caktuar përfundimisht oficeri i tretë që ka përmbyllur hetimet. Në kushtet që ende nuk ishte i administruar akti i ekspertimit kompjuterik dhe mund të kishte nevojë për hetime të tjera ose njoftimin e akuzës dhe pyetjen e të pandehurit, është proceduar me vendimmarrjen për zgjatjen e afatit të hetimit të datës 27.11.2014.

Nga fleta e regjistrit të Prokurorisë nuk rezulton që akti i ekspertimit të jetë dërguar në Prokurori, por është administruar në dosjen hetimore vetëm në datën 4.12.2014. Pas kësaj date, hetimet janë përmbyllur brenda 10 ditësh, duke mos u konsumuar në këtë mënyrë afati i plotë i vendosur në vendimin e zgjatjes së afatit të hetimit.

12. Vlerësimi ligjor i Komisionit – Për të mbështetur deklaratimet e tij, subjekti paraqiti në cilësinë e provës fletën e regjistrit të Prokurorisë së Rrethit Berat, fletën e regjistrit të ekspertimeve të Drejtorisë së Policisë Berat, kopje të fashikullit të procedimit penal dhe vendimin e gjykatës. Pas analizimit të tyre, Komisioni vëren se sipas shënimit të bërë në regjistrin e Policisë Shkencore të Drejtorisë Vendore të Policisë Berat, oficeri i fundit i çështjes K. S. e ka tërhequr aktin e ekspertimit kompjuterik në datën 4.12.2014 dhe se në datën 10.6.2014 ky akt rezulton të jetë

15.12.2014 është marrë vendimi për njoftimin e akuzës dhe marrjen si të pandehur, si dhe është mbajtur procesverbali i pyetjes së të pandehurit dhe njohjen e tij me aktet.

⁵⁹ Akti nuk është përcjellë në Prokurori nga oficeri i parë, për shkak të transferimit të tij, fakti që akti i ekspertimit mund të kishte ardhur në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat dhe/ose Sektorin e Policisë Shkencore nuk dihej as nga oficeri i dytë i çështjes, i caktuar si i tillë me vendimin e drejtuesit të Prokurorisë datë 23.6.2014. Në rastin konkret, rezulton se Drejtoria Vendore e Policisë Berat, pas transferimit të oficerit të çështjes, nuk ka njoftuar dhe nuk ka dërguar në Prokurori aktin e ekspertimit kompjuterik.

administruar në Sektorin e Policisë Shkencore në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat dhe jo në Prokurorinë e Rrethit Berat, çka përputhet me deklaratimet e subjektit në prapësime.

13. Rezulton e provuar se vendimet e zgjatjeve të afatit të hetimit i janë njoftuar rregullisht personit nën hetim, duke i garantuar në këtë mënyrë të drejtat procedurale që parashikon ligji dhe zgjidhja e çështjes vlerësohet në përputhje me interpretimin e drejtë të dispozitës ligjore, nenit 197 të Kodit Penal dhe faktit penal.

14. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shpjeguar bindshëm dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore të nevojshme lidhur me këtë procedim penal, si dhe nuk janë cenuar të drejtat e asnjë pale në proces. Sa rezulton, kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

15. Etika në punë – Konstatohet se gjuha e përdorur në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk rezulton të ketë pasur ankesa lidhur me etikën profesionale të prokurorit.

16. Integriteti – Nga informacionet e deklaruara nga vetë subjekti dhe dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

17. Paanësia – Nga dokumentet ligjore të analizuara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

18. Aftësitë e komunikimit – Nga dokumentet ligjore të analizuara vihet re se komunikimi i subjektit të rivlerësimit është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

19. Aftësia për të bashkëpunuar – Nga vlerësimet e punës për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, rezulton se subjekti është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

20. Gatishmëria për t’u angazhuar – Subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në disa trajnime në fushën penale, të organizuar pranë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, si dhe në trajnime të tjera jashtë programit të saj.

Hetimi i kryer nga Komisioni

21. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLP-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur, duke kërkuar informacion pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë⁶⁰, Prokurorisë së Përgjithshme⁶¹, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁶², Ministrisë së Drejtësisë⁶³ dhe

⁶⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 18.9.2023.

⁶¹ Shkresë nr. *** prot., datë 19.1.2021.

⁶² Shkresat nr. *** prot., datë 19.1.2021 dhe nr. *** prot., datë 18.9.2023.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 19.1.2021.

Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë⁶⁴, në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj tij, nga periudha 2006 e deri më sot. Në përfundim të hetimeve, Komisioni nuk konstatoi problematika që lidhen me vlerësimin e aftësive profesionale

22. Më tej, referuar indicieve të organeve verifikuese, Komisioni me anë të shkresës nr. *** prot., datë 31.1.2024, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, kërkoi administrimin e disa procedimeve penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit. Pas administrimit të dokumentacionit të kërkuar⁶⁵, u analizuan procedimet penale në vijim: (i) nr. ***/2014, me kallëzues shtetasin E. M., me palë të kallëzuar shtetasin P. S., për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; (ii) procedimi penal nr. ***/2019, në ngarkim të shtetasit S. B., për veprën penale “Përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal. Në përfundim të hetimit, lidhur me këto dy procedime penale, Komisioni nuk konstatoi problematika që lidhen me procesin e rivlerësimit. Ndërkohë që u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime lidhur me procedimin penal nr. ***/2018, në ngarkim të shtetasit S. T., për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal.

23. Rrethanat e faktit – Në datën 8.6.2018, nga ana e policisë gjyqësore është marrë informacion se në lagjen “***” në Berat, shtetasi S. T. po ndërtonte një objekt, pa u pajisur me lejen përkatëse të ndërtimit. Nga akti i ekspertimit rezultoi se ky shtetas ka kryer punime të rikonstruksonit të apartamentit, si dhe shtesë anësore në krahun e përparmë të banesës me sipërfaqe rreth 5 m². Në momentin e këqyrjes nga eksperti, punimet kanë qenë në kryerje e sipër dhe kanë përfunduar punimet e rifiniturës. Sipas aktit të ekspertimit, shtesa e re është jashtë konturit të pronës së shtetasit S. T. dhe është pjesë e sheshit para pallatit (pasuri shtet).

24. Nga hetimi administrativ kryesisht rezultoi se hetimet e këtij procedimi penal kanë zgjatur 21 muaj (rreth 2 vjet). Subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim 6 herë për zgjatjen e afateve të hetimit, nga ku prej datës 13.12.2018 deri më 13.9.2019 rezultoi se nuk është kryer asnjë veprim hetimor apo të jetë administruar dokumentacioni i nevojshëm në kuadër të këtij procedimi penal.

25. Për sa më sipër, subjekti paraqiti shpjegimet e tij në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se: Gjatë hetimit të këtij procedimi penal, me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm nr. ***, datë 13.11.2018 është caktuar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Shkodër. Prej këtij momenti është shkëputur çfarëdolloj marrëdhënieje me hetimin për këtë procedim penal. Me vendimin nr. ***, datë 25.1.2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi ndërprerjen e caktimit në Prokurorinë e Rrethit Shkodër dhe rikthimin në Prokurorinë e Rrethit Berat, ku efektivisht ka rifilluar në muajin shkurt, pas përfundimit të procedurës së dorëzimit të dosjeve në Prokurorinë e Rrethit Shkodër. Pra, përgjatë periudhës nëntor 2018 – shkurt 2019, subjekti nuk ka qenë në Prokurorinë e Rrethit Berat, për rrjedhojë nuk ka pasur asnjë kompetencë hetimi. Kjo kohëzgjatje përafërsisht 3-mujore ka ndikuar drejtpërdrejt në kohëzgjatjen e përgjithshme të çështjes. Për

⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 19.1.2021.

⁶⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 9.2.2024.

shkak të organikës së Prokurorisë së Rrethit Berat me vetëm 2 prokurorë dhe 1 drejtues prokurorie, nuk ishte e mundur shpërndarja e dosjeve të subjektit në prokurorë të tjerë⁶⁶.

Subjekti më tej deklaroi se në muajt shkurt – mars të vitit 2019 i janë caktuar rreth 230 dosje hetimore nga ato të dorëzuara prej tij në nëntor të vitit 2018, paralelisht me dosjet që shortoheshin normalisht përgjatë vitit 2019. Kjo ishte një situatë që shkaktoi mbingarkesë në hetime e, për rrjedhojë, ndikoi drejtpërdrejt edhe në shpejtësinë e hetimit të procedimit penal nr. ***/2018. Duke qenë se kishte shkëputje jo të vogël në kohë, ishte e nevojshme që të verifikonte fazën në të cilat ishin procedurat e bashkisë për mbikëqyrjen e zbatimit të lejes së ndërtimit nga i pandehuri apo konstatimin edhe prej tyre të cenimit të mundshëm të lejes së ndërtimit, me pasojë ndërtimin e paligjshëm, ashtu siç rezultonte me aktin e ekspertimit të kryer në hetim. Ky veprim është arritur të kryhet disa muaj më vonë, në nëntor të vitit 2019, dhe më pas është proceduar me veprimet procedurale për marrjen e personit si të pandehur, njoftimin e akuzës, pyetjen e tij etj. Shkaku që ka sjellë kryerjen e veprimeve hetimore me kohëzgjatje të tillë kohore ka qenë ngarkesa e lartë që u akumulua përgjatë vitit 2019, mbartur në vijim edhe në vitin 2020.

Subjekti deklaroi se ngarkesa ka kulmuar në fund të vitit 2019 me 821 dosje hetimore, çka përfaqëson një ndër ngarkesat më të larta të një magjistrati prokuror jo vetëm në ato vite, por edhe aktualisht. Gjithashtu paralelisht, në vitin 2019, në muajin qershor është caktuar zëvendës drejtues i Prokurorisë dhe në muajin shtator edhe prokuror mbikëqyrës për shërbimet e marrëdhënive me publikun, detyra shtesë të cilat kërkonin impenjim të veçantë. Në kushtet që kjo ngarkesë, si nga pikëpamja e hetimit, por edhe detyrave administrative (pa llogaritur çështjet e përfaqësuara në gjykim) ishte paralizuese për vijimësinë e punës. Drejtuesi i Prokurorisë me urdhrin e datës 10.2.2020 ka vendosur përjashtimin e përkohshëm nga shpërndarja e çështjeve, duke konstatuar se ngarkesa kishte tejkaluar kufijtë e normalitetit.

Përpos vështirësive të mësipërme, subjekti deklaroi se ka bërë përpjekje që nga pikëpamja procedurale penale të mos cenohej asnjë e drejtë e personit nën hetim, duke njoftuar rregullisht vendimet e zgjatjeve të hetimit, për të cilat nuk ka pasur ankim në gjykatë⁶⁷.

Gjithashtu, i pyetur në seancë nga anëtarët e trupit gjykues, subjekti deklaroi se ka qenë në vështirësi për të vënë në të njëjtën kohë në hetim një numër prej 230 procedimesh penale. Sipas subjektit, shumica e prokurorëve do të ndjenin një vështirësi të konsiderueshme duke qenë se përgjatë atij viti kishte marrë edhe 500 dosje të tjera paralelisht, që duhet t'i hetonte dhe rilexonte (pra t'i rikthehej edhe një herë ku e kishte lënë hetimin). Lidhur me përgjegjësinë e prokurorit mbi

⁶⁶ Nga numri i përgjithshëm prej 250-260 dosjesh të dorëzuara në të vitit nëntor 2018, ishte bërë e mundur që afërsisht 30 prej tyre të shpërndaheshin për shkak të ngutshmërisë që kishin (kryesisht dosje me persona me masë sigurimi “Arrest në burg” ose me masa të tjera sigurimi, përgjime, në limite të afateve hetimore etj.).

⁶⁷ Në përfundim, subjekti deklaroi se duke qenë se kjo çështje është shqyrtuar mbi bazën e indicieve të organeve verifikuese, dorëzoi në cilësinë e provës certifikatën e tij të sigurisë të lëshuar nga DSIK-ja. Më tej, paraqiti vërtetimin e lëshuar nga Prokuroria e Rrethit Berat mbi ngarkesën për vitet 2013 - 2021; raportet e analizave vjetore të Prokurorisë së Rrethit Berat për vitet 2018 – 2019 – 2020; raportin e Prokurorit të Përgjithshëm në mars 2023; urdhrin nr. ***, datë 13.11.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm, për caktimin e përkohshëm në Prokurorinë e Rrethit Shkodër; urdhrin nr. ***, datë 21.6.2019, të drejtuesit të Prokurorisë Berat, për caktimin si zv/drejtues të Prokurorisë; urdhrin nr. ***, datë 2.9.2019, të drejtuesit të Prokurorisë Berat, për caktimin si prokuror mbikëqyrës për shërbimin e marrëdhënive me publikun; urdhrin datë 10.2.2020, të drejtuesit të Prokurorisë Berat, për përjashtimin e përkohshëm nga shorti elektronik i shpërndarjes së çështjeve, si dhe kopje të fashikullit të këtij procedimi penal dhe vendimin e gjykatës.

monitorimin në kryerjen e detyrave në kohë nga ana e OPGJ-së, subjekti deklaroi se prokurori duhet të mbikëqyrë në mënyrë të vazhdueshme detyrat e lëna ndaj oficerit të policisë gjyqësore dhe se në rastin konkret ngarkesa ishte e tillë që e pamundësonte menaxhimin efektiv, të cilin trupi gjykues me të drejtë e konstaton.

26. Vlerësimi ligjor i Komisionit – Pasi u analizuan shpjegimet dhe provat e paraqitura, Komisioni vëren se në raportet e analizave vjetore të Prokurorisë së Rrethit Berat për vitet 2018 – 2021, subjekti në fund të vitit 2019 ka pasur 821 dosje hetimore të ngarkuara. Bazuar edhe në treguesit e raportit të Prokurorit të Përgjithshëm, kjo përfaqëson një ngarkesë tejet të lartë të një magjistrati, çka vërtetohet edhe me urdhrin nr. *** prot., datë 10.2.2020, të drejtuesit të Prokurorisë, ku është vendosur përjashtimi i përkohshëm nga pjesëmarrja në shortin elektronik të shpërndarjes së çështjeve për subjektin Olgert Rumnici. Gjithashtu referuar urdhrave të transferimit, vërtetohet se përgjatë periudhës nëntor 2018 – shkurt 2019, subjekti është emëruar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Shkodër. Duke qenë se edhe nga hetimi i Komisionit rezultoi e provuar se ky procedim penal nuk i ishte ngarkuar një prokurori tjetër, gjenden bindëse shpjegimet e subjektit se kohëzgjatja e gjykimit ka ardhur si rezultat i ngarkesës dhe shkëputjes nga hetimi i çështjes gjatë kohës së transferimit të tij.

27. Rezulton e provuar se vendimet e zgjatjeve të afatit të hetimit i janë njoftuar rregullisht personit nën hetim, duke i garantuar në këtë mënyrë të drejtat procedurale që parashikon ligji dhe zgjidhja e çështjes është kryer në përputhje me interpretimin e drejtë të nenit 199/a/2 të Kodit Penal dhe fakteve të konstatuara gjatë hetimit.

28. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka shpjeguar bindshëm dhe se janë ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore të nevojshme lidhur me këtë procedim penal, si dhe nuk janë cenuar të drejtat e asnjë pale në proces. Sa rezulton, kjo çështje nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

Denoncimet nga publiku

29. Pranë Komisionit, për subjektin e rivlerësimit Olgert Rumnici, janë administruar 4 denoncime nga publiku. Në 3 prej këtyre denoncimeve ngrihen pretendime për dhënien e vendimeve të padrejta dhe nuk përmbahen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit të subjektit, respektivisht denoncimet nr. *** prot., datë 30.5.2019 dhe nr. *** prot., datë 27.7.2020, të shtetasit M. K., si dhe denoncimi nr. *** prot., datë 17.12.2019, i shtetasit A. P. Ndërkohë që Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me denoncimin nr. *** prot., datë 11.12.2018, të paraqitur nga shtetasi D. G., i cili ankohet për dhënien e një vendimi të padrejtë për pushimin e procedimit penal nr. ***/2017.

30. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në datën 18.11.2017 ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pa autor. Kjo çështje në fillim i është ngarkuar prokurorit A. P., i cili me vendimin “Për zëvendësim e prokurorit” datë 23.1.2018 është zëvendësuar nga subjekti i rivlerësimit Olgert Rumnici. Më tej, rezultoi se në datën 23.11.2018 është marrë vendim “Për zëvendësimin e prokurorit”, Olgert Rumnici, me z. T. P., por pavarësisht

kësaj, Komisioni çmon të analizojë veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit, për sa kohë ai është shprehur me një vendim lidhur me këtë procedim penal.

31. Rrethanat e faktit – Shtetasit A. M. dhe D. G. kanë paraqitur kallëzim ndaj shtetasit L. S., duke pretenduar se me urdhrat nr. *** dhe nr. ***, datë 31.10.2017, ky shtetas, në cilësinë e drejtorit të ***-së Berat, ka urdhëruar ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të tyre në datën 1.11.2017, pasi nuk janë pjesë e strukturës së ***-së, si dhe lirin dhe përjashtimin e tyre nga shërbimi i mbrojtjes ndaj zjarrit në shkelje flagrante të ligjit, duke mos e pasur kompetencë për shkarkimin e tyre, kompetencë e cila i takon Drejtorit të Përgjithshëm të ***-së, duke konsumuar në këtë mënyrë elementet e veprës penale të parashikuara nga nenet 248 dhe 250 të Kodit Penal. Më tej, me urdhrat nr. *** dhe nr. *** prot., datë 10.11.2017, i kallëzuarit ka vendosur anulimin e urdhrave nr. *** dhe nr. ***, datë 31.10.2017 dhe vazhdimin e marrëdhënieve financiare të kallëzuesve që nga data 13.11.2017, urdhra këto të cilët nuk janë ekzekutuar. Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së, me shkresën datë 18.12.2017, pas kontrollit të ushtruar ka konkluduar se struktura e përcaktuar me vendimin nr. ***, datë 31.10.2017, të kryetarit të Bashkisë Berat, nuk reflekton orientimet e Ministrisë së Brendshme dhe urdhrat nr. *** dhe nr. *** të të kallëzuarit L. S. janë absolutisht të pavlefshëm si të nxjerra në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin, neni 15 i ligjit nr. 152/2015 dhe kanë orientuar Bashkinë Berat të konstatojë pavlefshmërinë absolute të tyre dhe marrjen e masës disiplinore ndaj të kallëzuarit L. S.⁶⁸.

32. Subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal me argumentimin se çështja i përket juridiksionit gjyqësor administrativ, duke arsyetuar se nga rrethanat e këtij procedimi penal dhe provat që i vërtetojnë ato rezultojnë se nuk është konsumuar vepra penale e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, por gjendemi përpara shkeljeve administrative nga drejtori i ***-së Berat. Subjekti në arsyetim e pranon faktin se vendimet për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare dhe ato për revokimin e tyre janë marrë jo në përputhje me ligjin, pasi i kallëzuarit nuk ka pasur kompetencë për të vendosur në rastin konkret, megjithatë mungojnë elementet objektive të veprës penale. Po kështu, mungon edhe ana subjektive në veprimet e të kallëzuarit, pasi këto vendime janë marrë prej tij mbi organikën e miratuar nga kryetari i bashkisë dhe janë revokuar duke bërë ndryshimet që impononte kjo strukturë, pra nuk ka fajësi në formën dashje, pasi vendimmarrja ka qenë e imponuar nga organika.

33. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat me vendimin nr. *** akti, datë 5.2.2019, e ka e çmuar të pabazuar vendimin e subjektit të rivlerësimit. Sipas gjykatës, ndryshe nga çka ka arsyetuar prokuroria, nuk ka ndonjë ndarje në ligj, e cila të bëjë diferencimin e detyrave funksionale me ato administrative të personit që ushtron një funksion publik. Po kështu, gjykata konstaton se ekzistojnë edhe pasojat, pikërisht dëmi financiar, ekonomik, i shkaktuar të kallëzuarve. Në rastin konkret, i kallëzuarit e ka ditur se po vepron në kundërshtim me ligjin duke kryer një veprim që nuk është në kompetencë të tij, por të Drejtorit të Përgjithshëm të ***-së (nuk mund të prezumohet se i kallëzuarit nuk njeh kuadrin normativ që normon funksionin e tij). Struktura e re ku nuk

⁶⁸ Në fashikullin hetimor është administruar edhe vendimi nr. ***, datë 24.5.2018, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me të cilin janë konstatuar si absolutisht të pavlefshme dhe në kundërshtim me ligjin, si vendimi i kryetarit të bashkisë nr. ***, datë 31.10.2017, ashtu edhe dy urdhrat e drejtorit të ***-së Berat, për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të kallëzuesve, duke u vendosur pranimi pjesërisht i kërkesëpadisë, kthimi në pozicionin e mëparshëm të punës i kallëzuesve dhe detyrimi i të paditurve për t'i paguar atyre pagat nga data 14.12.2017 deri në ekzekutimin e vendimit.

përfshiheshin dy kallëzuesit është miratuar nga kryetari i bashkisë sipas propozimit të të kallëzuarit L. S. Fakti se prej tij pak ditë më vonë janë revokuar këto urdhra, nuk do të thotë se me nxjerrjen e tyre ai nuk ka konsumuar elementet e veprës penale. Gjithashtu, rezulton se kallëzuesit kanë paraqitur kallëzim duke e akuzuar të kallëzuarin se ka kryer veprat penale të parashikuara nga nenet 248 dhe 250 të Kodit Penal dhe se organi i akuzës nuk ka analizuar, duke mos u shprehur fare lidhur me faktin nëse konstatohen apo jo elemente të veprës penale të parashikuara nga neni 250⁶⁹ i Kodit Penal, por ka analizuar kallëzimin vetëm lidhur me nenin 248 të tij, pasi e ka regjistruar procedimin penal për këtë vepër. Në përfundim, gjykata çmon se kërkesa e paraqitur nga ana e organit të akuzës, për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2017, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pa autor, është pjesërisht e bazuar në ligj dhe në prova, vetëm për sa i takon shtetasit P. S.⁷⁰, për rrjedhojë, urdhëron prokurorinë për të vazhduar hetimet.

34. Nga faktet e analizuarra më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimet se: (i) *Subjekti i rivlerësimit ka orientuar/drejtuar hapat hetimorë duke analizuar vetëm elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi e ka regjistruar procedimin penal për këtë vepër dhe nuk është shprehur në asnjë moment nëse konstatohen apo jo elemente të veprës penale të parashikuara nga neni 250 i Kodit Penal, sikundër ishte pretenduar në kallëzim;* (ii) *Duket se subjekti i rivlerësimit nuk është shprehur mbi pasojat/dëmin financiar-ekonomik, të shkaktuar ndaj të kallëzuarve, duke i cenuar të drejtën për punësim dhe ndërprerjen e pagës nga data 1.11.2017, gjë që ka ardhur si pasojë e drejtpërdrejtë e urdhrave të nxjerrë nga i kallëzuar.*

35. Për sa më sipër, subjekti paraqiti shpjegimet e tij në prapësime dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar se: Në këtë procedim penal nuk janë konstatuar fakte që i përkasin veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare. Për rrjedhojë, duke e gjetur të drejtë kualifikimin juridik të prokurorit të mëparshëm, ka vijuar hetimi bazuar mbi urdhrin e regjistrimit të hartuar nga ai prokuror për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë ka njohur kompetencën e prokurorit për të kryer vlerësim paraprak të fakteve që i paraqiten në kallëzim⁷¹. Raporti i veprës penale të shpërdorimit të detyrës me veprën e kryerjes së veprimeve arbitrare është një raport ndërmjet veprës penale të përgjithshme dhe veprës penale specifike, të cilat nuk mund të konkurrojnë ndërmjet njëra-tjetrës, kur bëhet fjalë për të njëjtin fakt penal që dyshohet se mund të jetë kryer (i ashtuquajtur i konkurrimit ideal), që nënkupton se mund të ekzistojë vetëm

⁶⁹ “Kryerja e veprimeve arbitrare” – Kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhrave arbitrare nga ana e punonjësit që kryen një funksion shtetëror ose një shërbim publik gjatë ushtrimit të detyrës së tij, të cilat prekin lirinë e shtetasve, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në 7 vjet.

⁷⁰ Pavarësisht se nuk është paraqitur kallëzim ndaj tij dhe as nuk është regjistruar procedim penal, organi i akuzës ka arsyetuar në lidhje me kryetarin e Bashkisë Berat, shtetasin P. S., se në veprimet e tij konstatohen shkelje administrative, të cilat nuk janë kompetencë shqyrtimi e organit të akuzës, por e Gjykatës Administrative⁷⁰. Pavarësisht se vendimi nr. ***, datë 31.10.2017, i kryetarit të Bashkisë Berat, vjen në kundërshtim me ligjin nr. 125/2015, “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi”, ai nuk përmban elementet e veprës penale të parashikuara nga neni 248 i Kodit Penal, pasi i mungon pasoja.

⁷¹ Konkretisht, në vendimin nr. ***, datë 12.9.2012, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, citohet: “Duhet pasur parasysh se jo për çdo kallëzim apo denoncim organi i akuzës është i detyruar të bëjë regjistrimin për procedimin penal dhe regjistrimi bëhet kur ai plotëson kushtet ligjore për nisjen e tij, gjë që do të thotë se duhet bërë një vlerësim paraprak për nisjen ose jo të procedimit penal...”. Ky qëndrim i jurisprudencës së vendit tonë është bazuar edhe në legjisllacionin dhe jurisprudencën e vendeve të tjera, kryesisht Italisë. Sipas një vendimi të Gjykatës së Kasacionit në Itali, *Cass. pen. n. 3261/1999*, përcaktohet se: “Parakusht i nevojshëm për të filluar hetimet paraprake është ekzistenca e një vepre penale (notitia criminis), e cila për të qenë e tillë duhet të ketë për objekt një fakt specifik, i cili përmban në vetvete ekstremet e një vepre penale dhe duhet të jetë i veshur për nga burimi nga i cili vjen, me një besueshmëri të caktuar”.

njëra prej tyre, por jo të dyja. Nëse gjatë hetimit të mëtejshëm të këtij procedimi penal do të konkludohej se mund të gjendeshim përpara veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare, do të procedohej me ndryshimin e kualifikimit juridik nga vepra penale e shpërdorimit të detyrës në veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare. Në përfundim, subjekti deklaroi se kualifikimi juridik ka qenë i drejtë dhe i bazuar ligjërisht.

Lidhur me konstatimin e dytë të Komisionit, subjekti deklaroi se ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore për të nxjerrë në pah të gjitha faktet e çështjes dhe se ka qenë e qartë që nga veprimet e të dyshuarit kanë ardhur pasoja financiare për kallëzuesit, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe e ka shprehur këtë në vendim, madje pa qenë e nevojshme kryerja e hetimeve shtesë, pasi bëhet fjalë për të ardhura nga paga, evidentimi i të cilave kryhet mbi bazë dokumentesh. Sa i përket themelit të çështjes, subjekti deklaroi se rasti i vetëm, kur në parim do të ishte e drejtë logjika e përdorur nga gjykata, do të ishte nëse legjislacioni penal do të parashikonte në mënyrë të shprehur përgjegjësinë penale për përfundimin e marrëdhënieve të punës në mënyrë të kundërligjshme, ashtu siç e ngarkon neni 7 i Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe neni 29 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Arsyetimi i gjykatës në vendimin nr. *** akti, datë 5.2.2019, është në kundërshtim edhe me praktikën e ndjekur deri aktualisht nga gjykatat shqiptare, të cilat në shumicë nuk i kanë konsideruar çështje të juridiksionit penal çështjet e vendimmarrjeve mbi përfundimin e marrëdhënieve të punës. Gjithashtu, gjykata ka qenë në tejkalim të kompetencave, duke marrë rolin e një gjykate administrative që gjykon mbi ligjshmërinë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës⁷².

36. Vlerësimi ligjor i Komisionit – Për të provuar arsyetimin e tij lidhur me konstatimin e parë, subjekti paraqiti si referencë (praktikë gjyqësore) vendimin nr. ***, datë 28.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku evidentohet pikërisht ky dallim: *“Për ngarkimin e personit me përgjegjësi penale sipas nenit 250 të Kodit Penal është kusht i domosdoshëm që veprimet arbitrare të kryera nga personi që kryen një shërbim publik të prekin lirinë e shtetasve. Nëse nga kryerja e veprimeve ose dhënia e urdhrave arbitrare nuk është cenuar liria e personit, por është cenuar ndonjë e drejtë tjetër themelore, kjo sjellje e kundërligjshme nuk do të përbëjë elementet e veprës penale të kryerjes së veprimeve arbitrare, por do të përmbajë elementet e veprave të tjera penale sipas rastit konkret”*. Gjithashtu, referuar provave të paraqitura në prapësime⁷³, konstatohet se në vijimësi të hetimeve është provuar se plotësohen vetëm elementet objektive dhe subjektive të veprës penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe jo elementet të veprës penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal, çka përputhet me veprimet e kryera mbi regjistrimin e këtij procedimi penal dhe vazhdimin e hetimeve nga ana e subjektit.

37. Lidhur me konstatimin dytë – Referuar provave të paraqitura, rezultoi se prokurori i cili ka zëvendësuar subjektin e rivlerësimit ka vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale dhe se me vendimin nr. ***, datë 4.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, i pandehuri është shpallur fajtor nga gjykata për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”.

⁷² Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti kopje të fashikullit të procedimit penal, vendimet e gjykatave, vendimin nr. *** të Gjykatës së Lartë dhe vendimin nr. ***, datë 28.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

⁷³ Vendim nr. ***, datë 4.10.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

38. Megjithatë, Komisioni merr në konsideratë me rezerva shpjegimet e subjektit, duke pasur parasysh se qasja dhe arsyetimi i tij në vendimin e dhënë ka të bëjë me faktin se sipas vlerësimit dhe bindjes së tij çështjet e vendimmarrjeve mbi përfundimin e marrëdhënieve të punës nuk konsiderohen çështje të juridiksionit penal dhe se kjo është një kompetencë e gjykatës administrative. Trupi gjykues nuk mund të marrë attribute për të vlerësuar lidhur me themelin e çështjes apo me arsyet që kanë çuar subjektin në vendimmarrjen e tij në këtë çështje dhe se problematikat e evidentuara dhe të shqyrtuara më sipër nuk përmbajnë shkelje serioze, nuk kanë shkaktuar pasoja procedurale dhe nuk mund të shërbejnë për të përgjithësuar punën e subjektit gjatë ushtrimit të detyrës së tij.

39. Bazuar në nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me anë të kriterit të aftësisë profesionale të prokurorit vlerësohet aftësia në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor⁷⁴. Komisioni çmon aftësitë profesionale pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

40. Në përfundim, në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive profesionale, duke pasur parasysh: (i) ushtrimin e detyrës së magjistratit bazuar në bindjen e tij të brendshme; (ii) mosvlerësimin mbi bazë të themelit të çështjes; (iii) moskonstatimin e gabimeve/mangësive të një natyre serioze dhe thelbësore apo të një serie në vazhdimësi të veprimeve/mosveprimeve të gabuara; (iv) ngarkesën e lartë të volumit të punës së përballuar nga subjekti i rivlerësimit – **trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit Olgert Rumnici është “i aftë” pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është eficient në masë të pranueshme.**

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Olgert Rumnici ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit

⁷⁴ Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. Aspekti i arsyetimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit.

Sprenger, si dhe referuar shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Olgert Rumnici, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, aktualisht i komanduar në pozicionin e këshilltarit ligjor pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 21.3.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Etlëda ÇIFTJA
Relatore

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj